UDHËZIM
Nr. 1362, datë 16.3.2016

MBI RREGULLAT NË VENDOSJEN E TARIFAVE TË AEROPORTIT1

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7(ç), të nenit 11, të ligjit nr. 10040, datë 22.12.2008, "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, dhe në përputhje me ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006, "Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe shteteve anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, për krijimin e një zone të përbashkët të aviacionit evropian",

UDHËZOJ:

Neni 1
Qëllimi dhe fusha e veprimit

1. Ky udhëzim përcakton rregullat e përbashkëta mbi vendosjen e tarifave aeroportuale në aeroportet e Republikës së Shqipërisë.

2. Ky udhëzim do të zbatohet për çdo aeroport të hapur për trafik tregtar, që ndodhet në Republikën e Shqipërisë, trafiku vjetor i të cilit është mbi pesë milionë lëvizje pasagjerësh dhe kur nuk ka një të tillë, në aeroportin me lëvizjen më të lartë të pasagjerëve në vend.

3. Duke konsideruar detyrimet e shtetit shqiptar, sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe, Autoriteti i Aviacionit Civil do të marrë masat për publikimin e listës së aeroporteve në territorin e Republikës së Shqipërisë, për të cilët aplikohet ky udhëzim. Kjo listë do të përditësohet çdo vit.

4. Ky udhëzim nuk do të zbatohet:

4.1 për tarifat e mbledhura nga të ardhurat e shërbimeve të lundrimit ajror, në rrugët ajrore (*en-route*) dhe terminal, në përputhje me përcaktimet e urdhrit të ministrit nr. 70, datë 13.5.2013, "Për miratimin e rregullores për përcaktimin e skemës së përbashkët të tarifave për shërbimet e lundrimit ajror",

4.2 për tarifat e mbledhura nga të ardhurat e shërbimeve në tokë (*ground handling*), të referuara në parashikimet e rregullores përkatëse,

4.3 për tarifat që merren për financimin e asistencës për pasagjerët me paaftësi për të lëvizur dhe pasagjerët me lëvizshmëri të kufizuar.

5. Ky udhëzim nuk kufizon të drejtën e organeve kompetente në Republikën e Shqipërisë për të aplikuar masa shtesë rregullative, në lidhje me ndonjë ent menaxhues aeroporti të vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë. Këto masa, të cilat nuk duhet të bien në kundërshtim me këtë udhëzim ose dispozita të tjera përkatëse që rregullojnë këtë fushë, mund të përfshijnë masa të mbikëqyrjes ekonomike, si miratimin e sistemeve të tarifave dhe/ose nivelin e tyre, duke përfshirë edhe metoda tarifimi nxitëse apo rregullore për tavanin e çmimit.

6. Ky udhëzim do të zbatohet pa cenuar dispozitat përkatëse të ligjit nr. 9312, datë 11.11.2004, "Për ratifikimin e marrëveshjes së koncesionit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë koncesionare "Tirana Airport Partners" sh.p.k., për ndërtimin, vënien në punë, operimin dhe mirëmbajtjen e aeroportit ndërkombëtar "Nënë Tereza", Tiranë dhe për dhënien e disa stimujve kësaj shoqërie koncesionare.

---

[1] Ky udhëzim përafron plotësisht direktivën e Parlamentit dhe Këshillit të Evropës nr. 2009/12/KE, të 11 marsit 2009, "Për tarifat e aeroportit".

Neni 2
Përkufizimet

Për qëllimet e këtij udhëzimi:

1. "Aeroport" nënkupton çdo sipërfaqe toke e përshtatur në mënyrë specifike për ulje, ngritje dhe manovrimin e avionëve, duke përfshirë instalimet ndihmëse të nevojshme për këto operime, në varësi të kërkesave të trafikut ajror dhe të shërbimeve, duke përfshirë instalimet e nevojshme për të ndihmuar shërbimet tregtare ajrore;

2. "Enti menaxhues i aeroportit" nënkupton një organ i cili, së bashku me aktivitetet e tjera ose jo, në përputhje me ligjet kombëtare, rregulloret apo kontratat në fuqi, ka si objektiv të tij administrimin dhe menaxhimin e aeroportit apo infrastrukturës së rrjetit të aeroporteve, koordinimin dhe kontrollin e aktiviteteve të operatorëve të ndryshëm, të pranishëm në aeroportet apo rrjetet e aeroporteve në fjalë;

3. "Përdorues aeroporti" do të thotë çdo person fizik ose juridik përgjegjës për transportin e udhëtarëve, postës dhe/ose të mallrave nga ajri, për në ose nga aeroporti në fjalë;

4. "Tarifë aeroporti" nënkupton një tarifë të mbledhur në favor të entit menaxhues të aeroportit dhe që paguhet nga përdoruesit e aeroportit për përdorimin e fasiliteteve dhe shërbimeve, të cilat sigurohen ekskluzivisht nga enti menaxhues i aeroportit dhe të cilat janë të lidhura me uljet, ngritjet, ndriçimin dhe parkimin e avionëve, si dhe me përpunimin e udhëtarëve dhe mallrave;

5. "Rrjeti i Aeroporteve " do të thotë një grup aeroportesh, i përcaktuar si i tillë sipas rregullave nga organi kompetent shtetëror dhe që operohet nga i njëjti ent menaxhues i aeroportit.

6. "Marrëveshje shumëpalëshe" është marrëveshja shumëpalëshe, shtojcat dhe protokolli I i saj, për krijimin e Zonës se Përbashkët Evropiane të Aviacionit (ZPEA), e ratifikuar me ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006, "Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe shteteve anëtare të tij, të Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe misionit administrativ të përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, "Për krijimin e një zone të përbashkët të Aviacionit Evropian", në vijim referuar si marrëveshja shumëpalëshe.

7. "Komisioni" është komisioni *ad-hoc*, i ngritur me funksionet e autoritetit kombëtar të pavarur mbikëqyrës që do të sigurojë zbatimin korrekt të masave të marra në përputhje me këtë udhëzim.

Neni 3
Mosdiskriminimi

Autoriteti i Aviacionit Civil do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që tarifat e aeroportit të mos jenë diskriminuese ndaj përdorueseve të aeroportit. Kjo nuk e pengon rregullimin e tarifave të aeroportit për çështje të interesit publik dhe të përgjithshëm, duke përfshirë çështjet e mjedisit. Kriteret e përdorura për një rregullim të tillë duhet të jenë të përshtatshme, objektive dhe transparente.

Neni 4
Sistemet e përbashkëta të tarifave

Autoriteti i Aviacionit Civil mund të lejojë entin menaxhues të aeroportit, për të paraqitur një sistem të përbashkët dhe transparent tarifash në aeroportet që i shërbejnë së njëjtës hapësirë urbane, me kusht që çdo aeroport të përmbushë kërkesat për transparencë të përcaktuara në nenin 6.

Neni 5
Konsultimi dhe miratimi

1. Autoriteti i Aviacionit Civil do të hartojë një procedure të detyrueshme, që rregullon konsultimin ndërmjet entit menaxhues të aeroportit dhe përdoruesve të aeroportit/përfaqësuesve të tyre ose shoqërive të përdoruesve të aeroportit, në lidhje me:

a) aplikimin dhe funksionimin e sistemit të tarifave aeroportuale;

b) nivelin e tarifave aeroportuale;

c) cilësinë e shërbimeve të ofruara.

Konsultimet do të zhvillohen të paktën një herë në vit, nëse nuk është rënë dakord ndryshe në konsultimin e fundit. Në rast se ekziston një marrëveshje shumëvjeçare ndërmjet entit menaxhues të aeroportit dhe përdoruesve të aeroportit, konsultimet do të zhvillohen siç janë parashikuar në këtë marrëveshje.

Autoriteti i Aviacionit Civil ka të drejtë për të kërkuar konsultime më të shpeshta.

2. Autoriteti i Aviacionit Civil do të marrë masa për të garantuar se, kurdo që të jetë e mundur, ndryshimet ose propozimet për ndryshime në sistemin apo nivelin e tarifave të aeroportit, të bëhen në marrëveshje mes entit menaxhues të aeroportit dhe përdoruesve të aeroportit.

2.1 Enti menaxhues i aeroportit, çdo propozim për ndryshime në sistemin apo nivelin e tarifave të aeroportit, shoqëruar me arsyet përkatëse, do ta paraqesë te përdoruesit e aeroportit, jo më vonë se katër muaj, para se ato të hyjnë në fuqi, përveçse kur ka rrethana të jashtëzakonshme, të cilat duhet të justifikohen për përdoruesit e aeroportit.

2.2 Enti menaxhues i aeroportit, do të kryejë konsultime me përdoruesit e aeroportit dhe do të marrë parasysh pikëpamjet e tyre mbi ndryshimet e propozuara, para se të merret një vendim.

2.3 Enti menaxhues i aeroportit normalisht do të publikojë vendimin e tij ose rekomandimin jo më vonë se dy muaj përpara hyrjes së tij në fuqi. Enti menaxhues i aeroportit do të justifikojë vendimin e tij në lidhje me pikëpamjet e përdoruesve të aeroportit, në rast se nuk është arritur një marrëveshje mes entit menaxhues të aeroportit dhe përdoruesve të aeroportit, mbi ndryshimet e propozuara.

2.4 Enti menaxhues i aeroportit publikon vendimin përfundimtar, pas miratimit nga ministri përgjegjës për transportin.

3. Në rast të një mosmarrëveshjeje, mbi një vendim të marrë nga enti menaxhues i aeroportit, mbi tarifat e aeroportit, sipas pikës 2.3, secila palë (enti menaxhues i aeroportit dhe përdoruesit e aeroportit) mund të kërkojë ndërhyrjen e Komisionit, siç përcaktohet në nenin 10, i cili do të shqyrtojë arsyet e argumentuara për modifikimin e sistemit apo nivelit të tarifave të aeroportit.

4. Kur enti menaxhues i aeroportit ka marrë një vendim për modifikimin e sistemit apo nivelit të tarifave të aeroportit dhe ky vendim është paraqitur për shqyrtim pranë Komisionit, ky vendim nuk do të ketë efekt deri sa komisioni ta ketë shqyrtuar çështjen.

Komisioni, brenda katër javëve nga dita që çështja është sjellë para tij, do të marrë një vendim të përkohshëm për hyrjen në fuqi të ndryshimit të tarifave të aeroportit, përveçse kur vendimi përfundimtar mund të merret brenda të njëjtit afat. Vendimi në çdo rast duhet të jetë në përputhje me pikën 6, të nenit 1, të këtij udhëzimi.

Neni 6

Transparenca

1. Autoriteti i Aviacionit Civil do të sigurojë që enti menaxhues i aeroportit i garanton çdo përdoruesi të aeroportit ose përfaqësuesve apo shoqatave të përdoruesve të aeroportit, se konsultimet e herëpashershme, siç përcaktohen në nenin 5 (1), do të përmbajnë informacion për komponentët që shërbejnë si bazë për përcaktimin e sistemit apo nivelit të të gjitha tarifave të mbledhura nga enti menaxhues i aeroportit.

Informacioni duhet të përfshijë të paktën:

a) një listë të shërbimeve të ndryshme dhe të infrastrukturës, të ofruar në këmbim të tarifës së mbledhur nga aeroporti;

b) metodologjia e përdorur për përcaktimin e tarifave të aeroportit;

c) struktura e përgjithshme e kostos në lidhje me facilitetetet dhe shërbimet me të cilat lidhen tarifat e aeroportit;

ç) të ardhurat e tarifave të ndryshme dhe kostoja totale e shërbimeve të mbuluara nga to;

d) çdo financim nga autoritetet publike të faciliteteve dhe të shërbimeve me të cilat lidhen tarifat e aeroportit;

e) parashikimet e situatës në aeroport për sa u përket tarifave, rritjes së trafikut dhe investimeve të propozuara;

f) përdorimi aktual i infrastrukturës së aeroportit dhe i pajisjeve gjatë një periudhe të caktuar; dhe

g) rezultati parashikuar i çdo investimi të madh, të propozuar, në aspektin e efekteve të tyre në kapacitetin e aeroportit.

2. Autoriteti i Aviacionit Civil do të sigurojë që përdoruesit e aeroportit të paraqesin informacion për entin menaxhues të aeroportit para çdo konsultimi, siç parashikohet në nenin 5 (1), të lidhur në veçanti me:

a) parashikimet për sa i përket trafikut;

b) parashikimet për sa i përket përbërjes dhe programimit të përdorimit të flotës së tyre;

c) planet e tyre të zhvillimit, në aeroportin në fjalë; dhe

ç) kërkesat e tyre në aeroportin në fjalë.

3. Në përputhje me legjislacionin përkatës, informacionet e dhëna në bazë të këtij neni do të konsiderohen si konfidencial ose ekonomikisht të ndjeshëm dhe do të trajtohen në përputhje me rrethanat. Në rastin e enteve menaxhuese të aeroporteve, që janë të kuotuara në tregun e bursës, do të jetë në përputhje dhe me rregullat për tregun e aksioneve.

Neni 7

Infrastruktura e re

Autoriteti i Aviacionit Civil do të marrë masa për të siguruar që enti menaxhues i aeroportit konsultohet me përdoruesit e aeroportit para se të finalizohen planet për projekte të reja infrastrukturore.

Neni 8

Standardet e cilësisë

1. Enti menaxhues i aeroportit dhe përfaqë-suesit ose shoqatat e përdoruesve të aeroportit në aeroport, do të hyjnë në negociata për të arritur një marrëveshje mbi nivelin dhe cilësinë e shërbimeve të ofruar në aeroport.

2. Autoriteti i Aviacionit Civil do të mbikëqyrë ecurinë e negociatave deri në arritjen e marrëveshjes, të cilat mund të zhvillohen edhe si pjesë e konsultimeve të përcaktuara në nenin 5 (1).

3. Çdo marrëveshje përcakton nivelin e shërbimit që do të ofrohet nga enti menaxhues i aeroportit, duke marrë në konsideratë sistemin ose nivelin aktual të tarifave të aeroportit dhe nivelin e shërbimit në këmbim të këtyre tarifave, që do të paguajnë përdoruesit e aeroportit.

Neni 9

Diferencimi i shërbimeve

1. Autoriteti i Aviacionit Civil do të marrë masa për të garantuar se Enti menaxhues i aeroportit mund të ndryshojë cilësinë dhe gamën e shërbimeve të veçanta të aeroportit, terminaleve apo pjesëve të terminaleve, me qëllim ofrimin e shërbimeve të përshtatura apo një terminali të dedikuar, apo për një pjesë të terminalit.

2. Niveli i tarifave të aeroportit, sipas pikës 1 të këtij neni, mund të diferencohet në bazë të cilësisë, qëllimit dhe gamës të këtyre shërbimeve ose ndonjë objektivi tjetër të arsyetuar dhe transparent. Pa rënë ndesh me nenin 3, Enti menaxhues i aeroportit mund të vendosë tarifa të tilla të diferencuara.

3. Enti menaxhues i aeroportit duhet të dorëzojë propozimin e tarifave të diferencuara pranë AAC-së.

Autoriteti i Aviacionit Civil do të lejojë çdo përdorues aeroporti që dëshiron të përdorë shërbime

të përshtatura për një terminal të dedikuar ose një pjesë të terminalit, që të ketë akses në këto shërbime.

4. Në rast se më shumë përdorues të aeroportit, se sa është e mundur për shkak të kufizimeve të kapaciteteve, dëshirojnë të kenë akses në shërbime të përshtatura dhe/ose një terminal të dedikuar ose në një pjesë të terminalit, aksesi do të përcaktohet në bazë të kritereve përkatëse, objektive, transparente dhe jodiskriminuese.

Këto kritere përcaktohen nga Enti menaxhues i aeroportit dhe miratohen nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

Neni 10

Autoritet i pavarur mbikëqyrës

1. Për zbatimin korrekt të masave të marra në përputhje me këtë udhëzim dhe, në veçanti, të detyrave të përcaktuara në nenin 6, ministri përgjegjës për transportin, me urdhër të veçantë, ngre komisionin *ad-hoc*, me funksionet e autoritetit të pavarur mbikëqyrës. Përbërja e komisionit është me përfaqësues nga strukturat e politikave të transportit ajror dhe autoritetit të aviacionit civil.

2. Komisioni sipas pikës 1 të këtij neni, është i pavarur nga çdo ent menaxhues i aeroportit dhe transportues ajror. Komisioni ushtron kompetencat e tij në mënyrë të paanshme dhe transparente.

3. Sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe, Komiteti i Përbashkët i saj do të njoftohet për adresën e Komisionit, detyrat dhe përgjegjësitë e caktuara, si dhe për masat e marra për të siguruar përputhjen me paragrafin 2 të këtij neni.

4. Komisioni do të sigurojë, në lidhje me mosmarrëveshjet e referuara në nenin 5 (3), se janë marrë masa:

a) Për të krijuar një procedurë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet Entit menaxhues të aeroportit dhe përdoruesve të aeroportit;

b) Për të përcaktuar kushtet sipas të cilave një mosmarrëveshje mund të paraqitet për shqyrtim pranë Komisionit. Komisioni, në veçanti, nuk do të trajtojë ankesat, të cilat i konsideron si të pajustifikuara siç duhet ose të padokumentuara në mënyrën e duhur; dhe

c) Të përcaktojë kriteret sipas të cilave mosmarrëveshjet do të vlerësohen për zgjidhje.

Këto procedura, kushtet dhe kriteret duhet të jenë jodiskriminuese, transparente dhe objektive.

5. Kur ndërmerret një hetim për arsyetimin për ndryshimin e sistemit ose të nivelit të tarifave të aeroportit, të vendosura siç përcaktohet në nenin 5, Komisioni do të ketë akses në informacionin e nevojshëm nga palët e interesuara dhe duhet të kërkojë që të konsultohet me palët e interesuara, në mënyrë që të marrë vendimin e tij. Pa rënë ndesh me nenin 5 (4), Komisioni do të nxjerrë një vendim përfundimtar, sa më shpejt të jetë e mundur, dhe në çdo rast brenda katër muajve që çështja është sjellë përpara tij. Kjo periudhë mund të zgjatet edhe dy muaj, në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara drejtë. Vendimet e Komisionit do të kenë efekt detyrues, pa paragjykuar ndonjë shqyrtim gjyqësor sipas legjislacionit në fuqi.

6. Komisioni do të publikojë një raport vjetor lidhur me aktivitetet e tij.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS

Edmond Haxhinasto